

**UDHËZIM**  
**Nr. 3, datë 22.4.2024**

**PËR SHFUQIZIMIN E UDHËZIMIT NR. 20, DATË 5.10.2010, “PËR  
PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE MBI PROCEDURAT PËR PLANET E  
FLUTURIMIT NË FAZËN E PARAFLUTURIMIT PËR QIELLIN E VETËM  
EVROPIAN”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të nenit 113 dhe të nenit 117, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

1. Udhëzimi i ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr. 20, datë 5.10.2010, “Për përcaktimin e kërkesave mbi procedurat për planet e fluturimit në fazën e parafluturimit për Qiellin e Vetëm Evropian”, shfuqizohet.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij udhëzimi.  
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
DHE  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
Belinda Balluku**